

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2021*

**19.04.2021
Ora 11:07**

RENDI I DITËS

**Projektvendim "Për pranimin për shqyrtim të Kërkesës Ankimore nr.12,
subjekti ankues PDIU".**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:** PDIU (Sh. Sulo)

Z. E. Lako: Përshëndetje! Vazhdojmë me seancën për të verifikuar shqyrtimin e elementëve të formës dhe përmbajtjes të Ankimit nr.12 të subjektit ankues PDIU, me objekt "Kundërshtimin e Vendimit nr.224 dt.13.04.2021 të KQZ-së, "Për shqyrtimin e raportit të Autoritetit të Medias Audiovizive të pasqyrimin të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 26.03.2021-03.04.2021". Relator i kësaj çështje jam zgjedhur unë, Elvin Lako sipas shortit të hedhur në dt. 16 Mars 2021. Të pranishëm në seancë janë anëtarët e KAS-it, Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe përfaqësuesi i PDIU zoti Shkëlqim Sulo. Palë të interesuara nuk ka. Duke pasur parasysh se seanca e sotme nuk ka të bëjë me shqyrtimin e themelit të çështjes por në përmbushje të kriterëve formale të ankimit që janë forma e ankimit, kompetenca e KAS për shqyrtimin e ankimit dhe respektimin e bazës ligjore për bëriën e ankimit, nenet 124, 126, 129 dhe 130 të Kodit Zgjedhor. Po shkurtimisht dy fjalë nga ankuesi.

**Zbardhi materialin audio
Silvi SINO**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2021*

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU-së: Subjekti zgjedhor PDIU i është drejtuar KAS duke kundërshtuar Vendimin nr.224 dt. 13.04.2021 të KQZ-së, Për shqyrtimin e raportit të Autoritetit të Medias Audiovizive të pasqyrimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 26.03.2021-03.04.2021. Përshkrimi është se Komisioneri ka vendosur ta përjashtojë këtë subjekt zgjedhor nga verifikimi i transmetimit në edicionin e lajmeve për balancimin e kohës sepse ne jemi pjesë e koalicionit. Në Kodin Zgjedhor është përcaktuar se cilat subjekte zgjedhore përfitojnë kohë televizive për ato që kanë përfituar më shumë se 20% të vendeve në Kuvendin e Shqipërisë.

Z. E. Lako: Shkurtimisht!

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU-së: Ne jemi subjekti zgjedhor që mendojmë të përfitojmë mbi këtë ankesë referuar nenit 168.

Z. E. Lako: Pretendoni se është bërë brenda afatit ligjor. Atëherë shkurtimisht zoti Sekretar i Përgjithshëm dy fjalë për plotësimin e elementëve të formës lidhur me kërkesën.

Z. Y. Merkaç: Atëherë, në datë 15.04.2021 subjektit ankues subjektin PDIU ka paraqitur pranë KQZ-së kërkesën ankimore me objekt kundërshtimin e Vendimit nr.224 dt. 13.04.2021 të KQZ-së, “Për shqyrtimin e raportit të Autoritetit të Medias Audiovizive të pasqyrimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 26.03.2021-03.04.2021”. Kërkesa është paraqitur në KAS dhe është brenda afatit ligjor dhe forma e kërkesës është sipas formatit të miratuar nga KQZ.

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2021*

Z. E. Lako: Dakord, faleminderit zoti Sekretar i Përgjithshëm, pyetje keni?

Z. L. Braho: Pyetje s'kam, thjeshtë për seancën e themelit nqs do vendosi KAS-i për vendimin e AMA-s nr.31 të datës 6.04.2021 mqs te propozimi i AMA-s është propozuar dhe minutazhi.

Z. Y. Merkaj: Patjetër, vendimi i AMA-s dhe raportet ditore që ka sjell AMA.

Z. E. Lako: Meqenëse nuk kemi ndonjë kërkesë tjetër për momentin KAS tërhiqet për vendim. Seanca e radhës do të jetë nesër datë 20.04.2021 ora 16:00, faleminderit.

Vendimi nr. 21

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2021*

**19.04.2021
Ora 11:31**

RENDI I DITËS

**Projektakti "Për shqyrtimin paraprak të Kërkesës Ankimore nr. 13, subjekti
ankues Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit".**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, E.Meta, A.Llano
- **Parti Politike:**
- **Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit:** A.Kalaja, M.Malkaj, A.Tolka

Z. I. Rusmali: KAS-i me short, ka caktuar mua si relator, Ilir Rusmali. Sot kemi caktuar seancën përgatitore. Në seancë përgatitore ne nuk merremi me thelbin e çështjes. Ne shqyrtojmë nëse çështja duhet të kalojë në seancë normale apo jo, pra merremi me disa elementë të formës, ka ardhur ankesa nga pala është sipas formës së kërkuar nga ligji, legjitimohet pala që ta bëjë këtë ankesë, është kompetencë e jona. Këto janë çështjet që ne trajtojmë sot, kështu që mbi këtë bazë ju mund të prezantoni kërkesën tuaj ankimore, por në këto elementë jo në elementë të përmbajtjes.

Znj. A. Kalaja, përfaqësuese e "Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit": Dakord! Atëherë ne ashtu siç e kemi cituar dhe në kërkesën tonë ankimore, jemi referuar një përgjigje të një shkresë që na ka ardhur nga Komisioneri Shtetëror dhe për këtë qëllim ne kemi

**Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2021**

bërë këtë kërkesë ankimore, në referim të nenit 21, pika b. Ne kërkojmë me kompetencat që ka KAS-i, ta shqyrtojë dhe ti japi zgjidhje administrative, kërkesës tonë. Kjo është thelbi i pjesës procedurale që ne bëjmë kërkesë, pastaj nëse doni kërkesën e themelit, sepse përpos që është komplet një përgjigje e papërgjegjshme, përpos që është një, jo, jo më fal,

Z. I. Rusmali: Jo nuk jam duke të kundërshtuar, jam duke thënë që mos futemi ke themeli.

Znj. A. Kalaja, përfaqësuese e “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Dakord dhe ne prandaj nuk ishim përpara faktit për të bërë një ankim kundra një vendimi të Komisionerit. Ne bëjmë një kërkesë dhe minimalisht Komisioneri, në referim të dispozitave ligjore duhet të merrte një vendim dhe për këtë arsye ne i drejtohem KAS-it, që ju në bazë të nenit 21, pika b, ta shqyrtoni dhe ti jepni zgjidhje këtij problemi. Kaq!

Z. I. Rusmali: Dakord, faleminderit! Ne kemi prezent Sekretarin e Përgjithshëm të KQZ-së këtu dhe ekipin e tij të cilët bëjnë analizën e tyre të kërkesës, gjithnjë nga elementët formalë.

Z. Y. Merkaç: Nga Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit në datën 26.03.2021, është paraqitur një kërkesë drejtuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në të cilin kërkohet heqja nga lista e kandidatëve për deputet, të disa deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, si: Edi Rama, Milva Konomi, Arben Ahmetaj, Blerina Gjylameti, Ervin Bushati, Elvis Bushi, Xhavit Sinaj, Artemis Malo, Lefter Koka, Antoneta Dhima, Roland Xhelili, Semida Mesi, Anila Denaj, Dallëndyshe Bici, Mirela Kumbaro, Toni

**Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2021**

Gogu, Plarent Ndreca, Romina Kuko, Klodeta Dibra, Etjen Xhafa, Arta Dovani dhe Ylli Shehu. Duke parë që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk është kompetent për këtë kërkesë dhe duke konsideruar që Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit nuk legjitimohet për bërjen e kësaj kërkesë i kemi kthyer përgjigje në rrugë administrative duke i thënë që nuk legjitimoheni. Në këto kushte brenda afatit, në datë 16.04.2021, ka paraqitur kërkesë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve me të njëjtën objekt ankimi duke kërkuar të njëjtën, përsëritur kërkesë që i kishin drejtuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Në këto kushte kërkesa ankimore që është pranë KAS-it, kemi përgatitur dokumentacionin, në qoftëse nga ana formale mund të flasim neni 180,

Znj. A. Kalaja, përfaqësuese e “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: A mundem?

Z. Y. Merkaj: Kërkesa nuk është nga ana formale sipas formës që është miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve gjithashtu, mesa e gjykojmë ne si administratë nuk është kompetencë e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Z. I. Rusmali: Dakord, kolegët pyetje?

Z. L. Braho: Jo unë një paqartësi kisha sepse Sekretari i Përgjithshëm tha që, Komisioneri Shtetëror i ka kthyer përgjigje që nuk legjitimohet. Të paktën në përgjigjen që ne kemi këtu, nuk më duket si çështje legjitimiteti këtu mesa shoh Komisioneri i ka hyrë themelit të kërkesës. A është kjo përgjigja, apo ka dhe ndonjë përgjigje tjetër?

Z. I. Rusmali: Po, ajo është.

**Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2021*

Znj. A. Kalaja, përfaqësuese e “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: A mund ta saktësoj?

Z. I. Rusmali: Jo të mbarojmë me pyetjet.

Znj. A. Kalaja, përfaqësuese e “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: E kam shumë të rëndësishme, jo u prezantua një gjë tjetër komplet nga realiteti,

Z. I. Rusmali: Mbase, mbase ne do të bëjmë pyetje për atë që do të flasësh ti.

Z. E. Çefa: Unë kam një pyetje, në çfarë date jeni njoftuar me këtë shkresën e Komisionerit?

Znj. A. Kalaja, përfaqësuese e “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Më ka ardhur me postë, datë 12 prill më duket. Shkresa ka datën 10, më 12.

Z. I. Rusmali: Në vijim të kësaj pyetje, ku është adresuar shkresa, aty ka një adresë, e kujt është ajo adresë.

Znj. A. Kalaja, përfaqësuese e “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Shkresa i është adresuar aktorit dhe regjizorit Edmond Budina po ta shikojmë në fakt për mua ka dhe mangësira të tjera, po thuhet zotit Edmond Budina dhe kërkuesve të tjerë dhe në fakt i ka shkuar në datë 13 de fakto, mund të verifikohet edhe nëpërmjet postës. Ne jemi njohur më datë 13 nëpërmjet kësaj shkrese që na e ka komunikuar zoti Budina,

**Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2021*

nëse do shikojmë ne jemi të gjithë kërkues nominalë, pra secili nga ne ka patur të drejtën që të njoftohet.

Z. I. Rusmali: Domethënë i është drejtuar në adresën private zotit Edmond Budina?

Znj. A. Kalaja, përfaqësuese e “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Po.

Z. I. Rusmali: Pra është adresa private, nuk është adresa e aleancës, duhet sqaruar,

Znj. A. Kalaja, përfaqësuese e “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Po.

Z. I. Rusmali: Po është e qartë.

Znj. A. Kalaja, përfaqësuese e “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Duhet sqaruar edhe kjo që ne nuk jemi subjekt politik.

Z. I. Rusmali: Prit të bëjmë pyetjen. Duhet të saktësojmë datën 12 apo datën 13 sepse ju na dhatë 2 data të ndryshme për marrjen e., domethënë na e sqaron dot këtë, cila është data?

Znj. A. Kalaja, përfaqësuese e “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Data 12 është data në zarfin e postës. Në fakt në banesën e zotit Budina, njoftimi ka shkuar në datën 13.

Z. I. Rusmali: Mund ta shohim atë zarfin? Edhe ne nuk marrim vesh shumë nga këto punë po mbase, ky është zarfi dhe kjo tregon që është dorëzuar apo që është marrë nga posta në datë 12?

*Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2021*

Znj. A. Kalaja, përfaqësuese e “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Unë mendoj që ajo është data e postës, kështu mendoj,

Z. I. Rusmali: Por faktikisht sipas jush është dorëzuar, faktikisht në datë 13?

Znj. A. Kalaja, përfaqësuese e “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Sipas asaj që na ka relatuar zoti Budina, në datë 13.

Z. I. Rusmali: Tani pyetja tjetër, na sqaroni pak, Aleancën për Mbrojtjen e Teatrit, ju thatë nuk është subjekt politik, do të thoni është i pa regjistruar në gjykatë, është pa organe drejtuese, pa statut? Aleanca është një,

Znj. A. Kalaja, përfaqësuese e “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Aleanca është një frymë, një lëvizje, një frymë dhe këto kanë qenë dhe nga pikëpamja procedurale qoftë kur jemi drejtuar SPAK-ut me 11 kallëzime penale, qoftë kur i jemi drejtuar dhe Gjykatës Kushtetuese, jo më tepër dua për legjitimimin,

Z. I. Rusmali: Po nuk na ndihmon neve,

Znj. A. Kalaja, përfaqësuese e “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Jo dua,

Z. I. Rusmali: Ne na ndihmon me fjalinë e parë, fjalitë e tjera na pengojnë,

Znj. A. Kalaja, përfaqësuese e “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Atëherë dua t’ju theksoj vetëm një fakt dhe kërkesën që kemi bërë në Gjykatën Kushtetuese e kemi

**Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI**



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2021**

bërë me emra nominalë po si kërkesa drejtuar Komisionerit dhe Gjykata Kushtetuese bazuar në gjithë veprimtarinë tonë, por mbi të gjitha bazuar mbi kallëzimet tona penale na ka legjitimuar si palë të tretë në procesin kushtetues.

Z. I. Rusmali: Na ndihmo ta çojmë përpara çështjen të lutem! Ju keni firmosur si individë në kërkesë 19 persona.

Znj. A. Kalaja, përfaqësuese e “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Po.

Z. I. Rusmali: Në kërkesë ankimore 17 persona. Jo 17 të tjerë, 17 nga këta 19 persona. Tani për nevojat e procesit tonë na lind në një pyetje. Ju jeni 3 persona që keni ardhur këtu. Jeni me autorizim, jeni domethënë keni një tagër përfaqësimi nga i gjithë grupi. Të lutem! Apo ju gjithsesi jeni 3 firmëtar?

Znj. A. Kalaja, përfaqësuese e “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Jo! Ne jemi 3 firmëtar dhe 3 ankimues dhe nuk kemi tagër nga grupi dhe grupi tjetër është poshtë për korrektësi, por ne vajza na tha që 2 deri 3 persona duhet të jenë në seancë, për,

Z. I. Rusmali: Rëndësi ka që ne na duhet, pa asnjë problem. Ne duhet ta saktësojmë këtë sepse pas nesh vjen dikush tjetër dhe thotë keni bërë gabim,

Znj. A. Kalaja, përfaqësuese e “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Patjetër, ne duam të respektojmë ligjin.

Z. I. Rusmali: Dakord! Ndonjë pyetje nga kolegët? Nuk ka pyetje tjetër? Dakord, as unë nuk kam pyetje. Ne duhet ta marrim një vendim tani ta pranojmë për shqyrtim

**Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2021*

apo jo, doni të thoni ndonjë gjë në fillim përpara se ta mbyllim, nëqoftëse keni ndonjë merak?

Znj. A. Kalaja, përfaqësuese e “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Dakord! Unë po flas dhe në emrin e 2 aktorëve që janë këtu prezent po flas dhe në emër të atyre që bënë kërkesën dhe atyre që bënë ankimimin. Siç jua parashtrova më lart, Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit, është një Aleancë e cila vepron në frymë, pra ne nuk jemi as të regjistruar si subjekt juridik por mbi të gjitha nuk kemi organe drejtuese, në këto kushte megjithë betejën tonë qoftë fizike, protestën qoftë dhe betejën ligjore e kemi ngritur mbi bazën e një morali që, ligji duhet të respektohet nga të gjithë dhe ligji është i barabartë për të gjithë. Në këto kushte unë mendoj që, së pari Komisioneri ka shkelur ligjin dhe së dyti ju si Komision i Ankimimeve duhet të ktheni besimin tek qytetarët se kur shkelet ligji qoftë dhe nga Komisioneri, qoftë dhe nga Kryeministri, një organ më i lartë duhet ta zbatojë atë. Ne jemi besimplotë se ju do merrni vendimin e duhur në zbatim të dispozitave ligjore!

Z. I. Rusmali: Shumë përgjegjësi na ngarkove mbi shpinë!

Z. Mehdi Malkaj, përfaqësues i “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Kam vetëm një gjë të vogël! Frymë, kjo fryma ka 3 vjet, 2 muaj dhe 11 ditë që është në protestë, pa i kërkuar llogari asnjërit, nuk hyn llogaria tek neve, ne e kemi me shumë dashuri!

Z. I. Rusmali: Dakord! Ne nuk diskutojmë çështjen e Aleancës, nuk diskutojmë as motivet tuaja, ne e kemi shumë elementarë debatin sot. Debati sot është për disa çështje që janë shumë strikte.

*Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2021*

Z. Mehdi Malkaj, përfaqësues i “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Shiko, jo, shiko i dashur unë që flas përballë me këtë që bëni ju jam si macja përballë bibliotekës, nuk kam lidhje unë me këtë, por di një gjë që thotë Shekspiri se fjala pa mendim në qiell nuk shkon.

Znj. A. Kalaja, përfaqësuese e “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Ne po përgatisim në fakt dhe një kallëzim penal kundra Komisionerit Shtetëror, sepse na duket që kemi shpërdorim të pastër të detyrës, në këndvështrimin tonë.

Z. I. Rusmali: Shiko këtu mbase na përçave si trup, se ca nga ne e duan Komisionerin ca nga ne e kanë inat.

Znj. A. Kalaja, përfaqësuese e “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Personalisht edhe unë e dua Komisionerin, po flasim,

Z. Mehdi Malkaj, përfaqësues i “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Në asnjë rast në Shqipëri nuk ka një gjë që s’është ndarë në dysh.

Znj. A. Kalaja, përfaqësuese e “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Ne po flasim për pozicionin dhe për vendimin e Komisionerit.

Z. I. Rusmali: Mirë, tani do na jepni mundësinë që të bëjmë një konsultë me ,

Znj. A. Kalaja, përfaqësuese e “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Patjetër! A mund ta marr zarfin unë?

*Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2021*

Z. I. Rusmali: Patjetër! Një konsultë me njëri-tjetrin, përpara se të vendosim, se çfarë do të bëjmë me kërkesën ankimore, nuk besoj që zgjat shumë,

Z. Mehdi Malkaj, përfaqësues i “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Ju lutem! Ne kemi për detyrë të presim. Jeni shumë të mirë. Faleminderit për dashurinë që na falët edhe me heshtjen tuaj!

Z. I. Rusmali: Suksese! Mirë, se ne një debat besoj do ta kemi.

RIFILLON SEANCA

ORA 12:21

Z. I. Rusmali: Siç e patë, u konsultuam më gjatë se çfarë e kishim menduar sepse vërtet patëm disa çështje që meritonin vëmendje, ju keni vënë në, unë po ju jap një shpjegim me fjalët e mia, do ta merrni me vendim por ne mund dhe ti bisedojmë gjërat në këtë formë, pastaj në vendim do ta keni gjënë të shkruar dhe me referenca korrekte. Ju i jeni drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me materialin që ju keni disponuar në atë kërkesë. Kodi Zgjedhor bën një ndarje midis subjekteve zgjedhore, organizatave të shoqërisë civile dhe individëve. Që të gjitha palët kanë të drejtë të vënë në lëvizje institucionin por jo të gjitha kanë të drejtë ta vënë për çdo gjë. I kanë të ndara fushën e tyre të veprimit. Siç thatë dhe ju, ju vini në KQZ jo si individë, grup individësh pra jo si organizatë e shoqërisë civile sepse organizata nuk ka personalitet juridik, por vini si grup individësh. Si grup individësh, të drejtat tuaja procedurale rregullohen nga neni 123/3 i Kodit, i cili ka lidhje me ato që ne i quajmë bilbilfryrës dhe ato kanë një pozicion procedural shumë specifik, ata e vënë në lëvizje me informacione institucionin. Institucioni gjykon dhe procedon në raport me informacionin por nuk merr vendim ndaj materialit. Pra, thjesht procedon

**Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI**

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2021*

materialin, në raport me bilbilfryrësit. Institucioni jep disa garanci që në rastin tuaj nuk duhen, se ju jeni njerëz publikë por në raste të tjera kanë rëndësi sepse mbron anonimatën dhe gjëra të tjera, pra kjo është logjika e pozicionit juridik tuajin dhe kjo na çon ne në konkluzionin për pyetjen e parë që na parashtrohet, që ju nuk legjitimoheni siç e mendoni, legjitimimi juaj është vetëm për këtë pjesë dhe për këtë pjesë ju e keni ezauruar lëvizjen procedurale, keni vënë në lëvizje KQZ-në dhe Komisioneri ju ka dhënë një përgjigje informative rreth çështjeve që kanë lidhje me dekriminalizimin. Ju mund të vini në KAS, të diskutojmë çështjen e kompetencës tonë, mund të vini në KAS për t'u ankuar ndaj vendimeve të Komisionerit, jo ndaj një shkrese të Komisionerit aq më tepër kur ajo është informative, do të thotë këtë procedurë ne mund ta bënim nëse do të ishte një vendim refuzues i një kërkesë të ligjshme dhe kjo është një arsye e dytë pse ne nuk e marrim dot në shqyrtim çështjen. Arsyeja e tretë pse ne nuk e marrim dot në shqyrtim çështjen ka lidhje me ligjin e dekriminalizimit, ose ta them me fjalë të zakonshme me mungesën e bazës ligjore të veprimit tuaj. Ligji i dekriminalizimit parashikon të drejta edhe të individëve, të grupeve të individëve, për të kërkuar verifikimin e integritetit të zyrtarëve të caktuar, por këto të drejta kanë një kusht, është një kusht numerik, duhet të jenë mbi 500 veta që ti kërkojnë institucionit të bëjë verifikime, duhet një numër e para, e dyta ligji i dekriminalizimit nuk lejon që individët qoftë edhe 500 veta të kërkojnë çregjistrimin e kandidatëve, domethënë tagri juaj është deri tek të kërkonin verifikim por jo çregjistrimin. Kështu që këto janë arsyet që ne na bëjnë të dalim në konkluzionin me unanimitet të gjithë që kërkesa, ne duhet të vendosim për mospranimin për shqyrtim të kërkesës. Ky është termi. Ju keni të drejtën e ankimimit ndaj këtij vendimi që ne morëm sot, do ta merrni maksimumi deri nesër edhe të zbardhur edhe me shkrim. Të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, brenda 45 ditëve nga dita e marrjes së vendimit, por ju këto i dini, i shqyrtoni vetë me ekspertizën tuaj

*Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2021*

që keni. Ky është në mënyrë të përmbledhur vendimi jonë. Na vjen keq që nuk merremi dot me çështjen, tani mekanzimat ligjore janë këta.

Znj. A.Tolka, përfaqësuese e “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Ndoshta është dhe i papërgatitur ligji,

Z. I. Rusmali: Ligji? Jo jo ligji është shumë i qartë, ke kjo,

Znj. A.Tolka, përfaqësuese e “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Se rasti jonë është unikal,

Z. I. Rusmali: Jo jo ligji është shumë i qartë ke kjo. Rruga që vihet në lëvizje KQZ-ja, domethënë dhe është futur rishtazi sepse ky nen është i futur rishtazi me reformën e fundit zgjedhore, por konteksti juridik është ky, nuk del dot jashtë.

Znj. A. Kalaja, përfaqësuese e “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Neni 21, pika b e shpreh qartazi,

Z. I. Rusmali: Kompetencën e KAS-it për të shqyrtuar ankimet ndaj vendimeve,

Znj. A. Kalaja, përfaqësuese e “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Po dhe zgjidhjen administrative,

Z. I. Rusmali: Për të shqyrtuar ankimet ndaj vendimeve,

*Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2021*

Znj. A. Kalaja, përfaqësuese e “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Jo ndaj akteve thotë, akti me vendimin kanë diferencë shumë të madhe,

Z. I. Rusmali: Ndaj akteve, dakord, ke shumë të drejtë! Akti është termi i përgjithshëm.

Znj. A. Kalaja, përfaqësuese e “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Ajo pikë është sipas nesh të paktën, sepse secili mbron llogoren e vete, sipas nesh,

Z. I. Rusmali: Dakord! Mirë! Ju keni të drejtën e ankimit, ju keni të drejtë që të jeni të pakënaqur me,

Znj. A. Kalaja, përfaqësuese e “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Ne jse, mua personalisht më duket si një unison me pushtetin dhe në fakt është e papranueshme dhe më duket më shumë e papranueshme ngurimi i Komisionerit për të hetuar.

Z. I. Rusmali: Dakord! Domethënë, unë duhet ta mbyll si mbledhje këtu pastaj e diskutojmë sepse kjo është jashtë mbledhjes!

Znj. A. Kalaja, përfaqësuese e “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Jo jo, por nuk ka se çfarë të diskutojmë, ne vendimin e morëm.

Z. I. Rusmali: Por si mbledhje jam i detyruar ta mbyll këtu.

Znj. A. Kalaja, përfaqësuese e “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Vendimin e morëm dhe shikoj një frikë për të hetuar ndaj zyrtarëve.

*Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2021*

Z. Mehdi Malkaj, përfaqësues i “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Thotë Shekspiri kur duam të shpjegojmë së nata është natë, dita ditë dhe koha kohë nuk bëjmë gjë tjetër vetëm humbasim ditën, natën dhe kohën dhe unë e mora mesazhin e qartë.

Znj. A. Kalaja, përfaqësuese e “Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit”: Mirupafshim!
Punë të mbarë!

Z. I. Rusmali: Mirupafshim! Punë të mbarë edhe ju!

Vendimi nr. 22

*Zbardhi materialin audio
Romina KOKOSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2021*

**19.04.2021
Ora 12:30**

RENDI I DITËS

Projektakti "Pranimi për shqyrtim i kërkesës ankimore nr. 14, datë 16.04.2021 nga Kryetari i Bashkisë Vorë, zoti Gentian Picari "Kundërshtimin e vendimit nr. 234, datë 14.04.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për sanksion administrativ që ju keni marrë ndaj Kryetarit të Bashkisë Vorë zotit Gentian Picari".

PJESËMARRJA :


- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, E.Meta, A.Llano

Z. K. Bele: Kërkesë ankimore me ankues Gentian Picari, Kryetari i Bashkisë Vorë, kërkesa ankimore numër 14 e datës 16.04.2021. KAS ka hedhur shortin sipas procedurës dhe unë jam relatori i çështjes Koli Bele dhe sot po shqyrtojmë lidhur me elementët e formës dhe përmbatjes së kësaj kërkesë do të bëjmë verifikimin nëse kërkesa plotëson kushtet dhe kriteret për të kaluar në shqyrtimin administrativ. Shumë shkurt prezente kush është?

Znj. Dafina Gjokolaj përfaqësuese ligjore e zotit Gentian Picari: Juriste pranë Drejtorisë së Prokurimit Publik dhe Çështjeve ligjore me autorizim nr.3320 protokoll, i datës së sotëshme.

Z. K. Bele: Faleminderit, në rregull depozitojeni.

**Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2021*

Z. I. Rusmali: Ne jemi komisioni i tenderit.....

Z. K. Bele: Nuk ka gjë, ju jeni juriste.

Znj. Dafina Gjokolaj përfaqësuese ligjore e zotit Gentian Picari: Jo, jam në çështjet ligjore, përfaqësuese për në gjykatë. Është hera e parë në fakt që unë jam pjesë e kërkesës ankimore në KAS, është shumë kënaqësi.


Z. K. Bele: Nuk ka gjë, të gjithë kemi qenë diku për herë të parë në një gjykatë apo komision....

Znj. Dafina Gjokolaj përfaqësuese ligjore e zotit Gentian Picari: Jo, në gjykatë e kam bërë si në shtëpinë time, po këtu tek ju është hera e parë, është shumë kënaqësi.

Z. K. Bele: Edhe ne “quasi gjykatë”, mendojmë ndonjëherë që jemi. Megjithatë prezente është gjithashtu administrata e KQZ-së, Sekretari i Përgjithshëm. Shumë shkurt ne i kemi aktet përpara, dy fjalë për çfarë e vë në lëvizje KAS-in.

Znj. Dafina Gjokolaj përfaqësuese ligjore e zotit Gentian Picari: Në rregull. Atëherë, siç shpresoj edhe ju jeni njohur me kërkesën ankimore që ju kemi bërë, që shpresoj të jetë të paktën në përmbatje siç janë rregullat. Kemi bërë një ankesë për kundërshtimin e vendimit nr.234 datë 14.04.2021 për sanksion administrativ që ju keni marrë ndaj Kryetarit të Bashkisë Vorë zotit Gentian Picari në masën 10 mijë lekë, për mos zbatim të vendimit numër 140 datë 15.03.2021. Atëherë, referuar edhe përmbatjeve të ligjeve në fuqi siç shpresojë nuk është e nevojshme t'i citojë pasi janë

**Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2021*

këtu, janë në rregull, të paktën me aq sa kam parë edhe unë. Shkelja e pretenduar nga ana juaj ishte mos zbatimi i vendimit nr.140 që ju kishit marrë.

Z. K. Bele: Më fal, ki parasysh që këtu po shikojmë vetëm elementët e formës pastaj nëse KAS do të vendos kalimin në shqyrtim ne do të hyjmë tek elementët e përmbatjes. Pra, do shikojmë themelin e çështjes përse ju pretendoni. Në këtë fazë...

Znj. Dafina Gjokolaj përfaqësuese ligjore e zotit Gentian Picari: Në rregull, mos të futem në themel....

Z. K. Bele: Jo, verifikohen vetëm elementët e formës dhe paraprakisht në fakt unë do të pyesja. Jeni në dijeni që në përgjithësi këto kërkesat kanë një format të caktuar bëhen?

Znj. Dafina Gjokolaj përfaqësuese ligjore e zotit Gentian Picari: Unë e pashë formatin, u mundova t'i përmbahem. Ndoshta e kam përshtatur. A është ky formati kështu? Por besoj se i ka të gjithë elementët thjesht është në një....

Z. K. Bele: Thjesht nuk është mbushur sipas kornizave...

Znj. Dafina Gjokolaj përfaqësuese ligjore e zotit Gentian Picari: Është mbushur në një formë tjetër. Gjithsesi ju e dini kështu që....

Z. K. Bele: Dakord.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2021*

Znj. Dafina Gjokolaj përfaqësuese ligjore e zotit Gentian Picari: Nëse nuk është sipas formës që kërkon ligji më thoni edhe unë e plotësoj.

Z. K. Bele: Në fakt është një akt nënligjor që e Megjithatë ne do t'a diskutojmë këtë me njëri tjetrin. Mirë, zoti Ylli ke ndonjë gjë për të thënë.

Z. Y. Merkaj: Kërkesa është paraqitur brenda afatit të përcaktuar nga ligji, pasi ankimon vendimin e datës 14.04.2021. Ankimi është paraqitur brenda afatit në datë 16.04.2021, është paraqitur pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve që është kompetent për shqyrtimin e ankimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Ankuesi legjitimohet në ngritjen e kësaj kërkesë por nga ana formale nuk ka respektuar kërkesën ankimore të miratuar me vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve model-K.A, Kërkesë- ankimore.

Z. K. Bele: Një pyetje që nuk ka lidhje me çështjen. Ky formati, thjesht kjo është pak pyetje kështu për në të ardhmen çfarë do të ndodhi. Mendon që ditën e zgjedhjeve të gjitha kërkesat që do na vijnë nga KZAZ-të apo potencialisht do të jenë brenda këtij formati?

Z. Y. Merkaj: Shpresojmë që të jenë të gjitha brenda këtij formati.

Z. K. Bele: Mendon që do arrijnë ata dhe nëse nuk do arrijnë ata ne duhet t'ia kthejmë ditën e zgjedhjeve këtë format?

Z. Y. Merkaj: Të paktën KZAZ i kemi vënë, janë të njohura

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2021*

Z. K. Bele: I keni vënë në dijeni.

Z. L. Braho: Trajnohen për atë punë.

Z. K. Bele: Mirë, kemi ndonjë pyetje për përfaqësuesen?

Znj. Dafina Gjokolaj përfaqësuese ligjore e zotit Gentian Picari: Më fal a mund të them diçka, të paktën vizualisht nuk është i njëjtë se besoj se elementët janë të gjitha të paraqitura.

Z. K. Bele: Mirë, e thatë këtë. E qartë!

Znj. Dafina Gjokolaj përfaqësuese ligjore e zotit Gentian Picari: Thjesht ndoshta vizualisht.

Z. K. Bele: Kjo është nga ato çështje që kanë nge. Domethënë në të dyja rastet edhe nëse ne eventualisht do t'a kthenim për formatin ju do t'a sillnit edhe po t'a kalojmë thelbin nuk e humb kështu që ...

Z. L. Braho: Ndoshta mund të na i thotë administrata, mungon ndonjë nga elementët e formatit apo jo? Përveç pjesës së kornizave?

Z. K. Bele: Përveç kuadratit?

Z. Y. Merkaj: Jo, jo. I ka të gjitha elementët që plotëson, që kërkon një kërkesë.

Zbardhi materialin audio

Ardita VRIONI



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.04.2021*

Z. K. Bele: Mendoni që do duhet t'a diskutojmë pak ne këtë pjesën që çfarë qendrimi do të mbajmë për t'a standartizuar këtë?

Z. I. Rusmali: Jam dakord që të procedohet.

Z. L. Braho: Edhe unë.

Z. K. Bele: Atëherë, KAS unanimisht vendos kalimin në seancë të kërkesës. Data që do të propozoja ora 11:00 ose 12:00 meqë kemi mbajtur këtë standard., të ditës së Mërkurë, nëse nuk kemi ndonjë gjë?

Z. L. Braho: Data 21? Jo, në rregull.

Z. K. Bele: Ndonjë sugjerim për orën 11 ose 12....

Z. E. Çefa: Po nesër në orën 17:00 ...

Z. K. Bele: Po në datë 20 ora 17:00, për shqyrtim. Ju faleminderit!

Vendimi nr. 23

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*

